



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 503, Datë 21.03.2018

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 490, datë 20.12.2017 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2018, shqyrtoi çështjen me:

- Objekti:** Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 490, datë 20.12.2017 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines”
- Baza Ligjore:** Neni 8, neni 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 490, datë 20.12.2017 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines për periudhën kohore nga 1 Janar 2017 deri në 31 Dhjetor 2017 dhe raporti i hetimit paraprak të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak u krye inspektim pranë degës në Shqipëri të ndërmarrjes Austrian Airlines AG, si dhe u kërkua informacion nga kjo ndërmarrje dhe nga Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC).

3. Pas depozitimit të informacionit të kërkuar dhe përpunimit të tij, rezulton se për të kryer një analizë më të plotë të sjelljes së ndërmarrjes Austrian Airlines duhet të kërkohet informacion shtesë nga kjo ndërmarrje dhe nga AAC.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se sigurimi i një informacioni të plotë dhe të detajuar dhe dëgjimi i të gjitha palëve të përfshira në këtë hetim, për të parë më mirë sjelljen e ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 490, datë 20.12.2017 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines”, pika “3”, të ndryshohet si vijon:
“3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 29 maj 2018.”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS